



**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova – Republic of Kosovo	Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalışe - Razvijač - Otvoreno	No.Nr. 001-23
Tarih/Dt. 05.01.2023	

Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 04.01.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Bajram HA. Gashi” B.I. nga Suhareka, bie këtë :

## VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Bajram HA. Gashi” B.I. nga Suhareka e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 04.01.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-22-9826-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-22-021-1-2-1 me titull: “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”-Ritender

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik **Bajram HA. Gashi** B.I. nga **Suhareka** me datë 04.01.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për anulim të procedurës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “**Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse**”-Ritender

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtaur të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1 dhe 7 të LPP-s si dhe neni 3 pika 4.1 dhe 4.4 të RrUOP. Konsiderojmë që gjitha këto pretendime te shkëljes së LPP-s dhe rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues është cekur se pasi që ne jemi kompania e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe padrejtësisht AK na ka mohuar të drejtën tonë legitime që të jemi punëkryesit e këtij projekti, me gjithë dokumentacionin dhe arsyetimin e ofruar në pyetjen e AK-s për arsyetim të çmimeve. Prandaj ne kërkojmë që vendimi i datës 30.11.2022 të kthehet në rishqyrtim sepse është i kundërligjshëm, AK me këtë vendim ka nxjerrë standarde të dyfishta në mënyrën sesi i janë qasur dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana jonë me kërkesë të tyre (AK), andaj një qasje e tillë përveç se është joprofessionale është po aq edhe e kundërligjshme.

Pretendimi në fjalë, është paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur pas vendimit të AK-s të datës 30.11.2022 edhe përkundër se lënda është kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit, vendimi për anulim të procedurës në fjalë është marrë me datën 27.12.2022 andaj O.E. ankues është dashur ta kundërshtoj vendimin e datës 27.12.2022 dhe jo vendimin e parë të datës 30.11.2022.

Sikur kemi cekur në letrën standarde komisioni vlerësues ka konstatuar që Operatori Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I. i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirëpo në disa artikuj ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut. Edhe pse me datë 10.11.2022 O.E. i është përgjigjur kërkesës për sqarim komisioni ka konstatuar që sqarimi nuk është i mjaftueshëm pasi që O.E. ankues si dëshmi apo referencë të çmimeve të vendosura ka paraqitur oferta fiktive të cilat nuk përkojnë me çmime të tregut.

Gjithashtu nuk pajtohem i me pretendimin e O.E. ankues që vendimi është i kundërligjshëm dhe se AK me këtë vendim ka nxjerrë standarde të dyfishta në mënyrën sesi i janë qasur dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana jonë me kërkesë të tyre (AK), andaj një qasje e tillë përveç se është joprofesionale është po aq edhe e kundërligjshme, pasi që ky është një pretendim plotësisht i pa bazë. O.E. ankues nuk ka cekur dhe nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie se cilit dokumentacion të paraqitur nga O.E. pos dokumentacionit të tyre i jemi qasur ndryshe apo në mënyrë të njëanshme për tu konsideruar standarde të dyfishta! Pasi që gjatë vlerësimit ka pasur ofertues më të lirë se O.E. ankues por që të njëjtit i është refuzuar tenderi pasi që në disa artikuj ka ofruar çmimet tepër të ulëta ndërsa në disa artikuj tjerë ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues nuk ka pasur asnjë vërejtje në lidhje me qasjen, gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Në këtë pretendim O.E. ankues ka cekur që kinse janë diskriminuar sepse oferta e tyre është oferta e përgjegjshme më e lirë gjë e cila nuk është e vërtetë, pasi që në mesin e ofertuesve ka pasur ofertë më të lirë e cila i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë por që për shkak të çmimit jo normalisht të ulët si dhe për shkak që në disa artikuj ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut oferta i është refuzuar. Është e ulët shprehja e O.E. ankues se AK ka pasur qëllime tendencioze sa i përket vlerësimit dhe vendimit, pasi që ne nuk kemi favorizuar apo diskriminuar asnjë O.E. pjesëmarrës, por në këtë rast edhe pse është munduar të shfajësohet duke manipuluar me çmime O.E. ankues është i vetëdijshëm se ka vendosur çmime tepër të larta dhe është munduar që ti mbuloj me oferta fiktive.

Më tej operatori ekonomik ankues, është munduar që të arsyetohet se janë më të lirët në shumë pozicione krahasuar me ofertat e pjesëmarrësve të tjera në këtë proces tenderimi dhe se çnimet e vendosura nga ata, janë çmime të diktuar nga tregu dhe asgjë me tepër dhe se janë siguruar që të ofertojë në mënyrë dinjitoze duke ofruar fillimisht cilësi të materialeve me të cilat punohet dhe kualitet të shërbimeve dhe

natyrisht duke menduar edhe për fitimin e tyre, i cili bazuar në ofertat e pranuar nga furnitorët, dokumentacionet e së cilave i kanë dërguar sipas kërkesës tonë, do ta siguronin një fitim mjaft modest d.m.th jo shumë të lartë.

Ky sqarim nuk është i qëndrueshëm pasi që të dy komisionet vlerësuese (ai i vlerësimit të parë dhe ai i rivlerësimit) gjatë vlerësimit të tenderit kanë dalë në hulumtim të fregut dhe kanë konstatuar që në disa pozicione të cilat kanë përdorim më të shpeshtë, sikur janë artikujt: **Pjesa A. Pozicionet: 9, 20, 27 dhe 29** **Pjesa B. Pozicioni: 9, 28 dhe 37.** **Pjesa C. Pozicionet: 9, 11, 13, 25, 49, 51, 66, 70, 77, 78, 79, 81, 83, 84, 86 dhe 90** operatorit ekonomik ankues ka ofruar çmimet tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Po i marrim shembull artikujt: Nr. 29 në pjesën A në të cilin është kërkuar Furnizimin dhe montimi i dorezave për hapjen dhe mbylljen e dritareve (të plastikës, drurit dhe aluminit) nga prodhuesit Winkhouse, Rroto ose të ngjashme me këto prodhime e cila në treg sipas hulumtimit të komisionit vlerësues kushton 2.00 € deri në 5.00€, ndërsa O.E. ankues këtë pozicion e ka ofertuar 255.00 € dmth nëse e kthejmë në përqindje del çmimi diku rreth 99.2 % më i lartë se çmimi i tregut.

Gjithashtu artikulli në pjesën C pozicioni nr. 84 në të cilin është kërkuar furnizimi dhe montimi i klimave për zyre me kapacitet 24000 BTU e cila në treg sipas hulumtimit të komisionit vlerësues kushton 840.00 € deri në 900.00 €, ndërsa O.E. ankues këtë pozicion e ka ofertuar 1200.00 € dmth nëse e kthejmë në përqindje del çmimi diku rreth 42.86 % më i lartë se çmimi i tregut.

Gjithashtu artikulli në pjesën C pozicioni nr. 90 në të cilin është kërkuar furnizimi dhe montimi i klimës të tipit ALL Easy Pro Inverter MSEPBU-12 HR FN 8 – QRDOGW, për zyre me kapacitet 3.51 KW e cila në treg sipas hulumtimit të komisionit vlerësues kushton 465.00 € deri në 500.00 €, ndërsa O.E. ankues këtë pozicion e ka ofertuar 1200.00 € dmth nëse e kthejmë në përqindje del çmimi diku rreth 158.06 % më i lartë se çmimi i tregut. Për të mos vazhduar me artikujt tjera për të cilët është kërkuar sqarim, më poshtë po vendosim çmimet të shkëputura nga oferta në treg të marra nga komisioni vlerësues në të cilën shihen dallimet.

Shtira e artikujit Article code	Perspektimi i mallit Goods description	VAT %	Pako Pack	Ivo pako In pack	Injesia Unit	Sasia Quantity	Pa Cmimi Price	TVSH - VVJEDOU VAI Zbrilla Allowance	Vlera-Amount	TVSH VAT	Me Cmimi Price	TVSH - With VAT Vlera-Amount
2125452675830 Ceshme kopshti mesing 1/2 VK011 1	Ceshme kopshti mesing 1/2 VK011	18	0	1	COPE	1.00	4.661	0.00	4.66	0.84	5.50	5.50
0000052105 FL2000 Tharese per duar me rryme 2	FL2000 Tharese per duar me rryme	18	0	1	COPE	1.00	31.780	0.00	31.78	5.72	37.50	37.50
0000000004441 Skllopka Energoinvest MC5-8 3	Skllopka Energoinvest MC5-8	18	0	1	COPE	1.00	10.169	0.00	10.17	1.83	12.00	12.00
6005690800691 Dorza Dyerje PVC bmx 3756 qels. 4	Dorza Dyerje PVC bmx 3756 qels.	18	0	1	PAR	1.00	1.695	0.00	1.39	0.31	2.00	2.00
6000569082111 Cilindra Ruitai 80mm me Rot 5	Cilindra Ruitai 80mm me Rot	18	0	1	COP	1.00	5.085	0.00	5.09	0.92	6.00	6.00
8600096074774 Minium Zvezda Hiri 0.75L 6	Minium Zvezda Hiri 0.75L	18	0	1	COPE	1.00	2.119	0.00	2.12	0.38	2.50	2.50
8697702280100 Dryna Yuma 80mm YM-3080R 7	Dryna Yuma 80mm YM-3080R	18	0	1	COP	1.00	8.390	0.00	8.39	1.51	9.90	9.90
3838717160123 Shati M1/100 8	Shati M1/100	18	0	1	COP	1.00	6.610	0.00	6.61	1.19	7.80	7.80
8606010110276 Grabuj Metali 14Dhembi Unitehna 9	Grabuj Metali 14Dhembi Unitehna	18	0	1	COPE	1.00	3.814	0.00	3.81	0.69	4.50	4.50
6000569086220 Bishta Grabuje 10	Bishta Grabuje	18	0	1	COP	1.00	1.102	0.00	1.10	0.20	1.30	1.30
3838717294484 Lopata Struc L151/90 11	Lopata Struc L151/90	18	0	1	COPE	1.00	5.508	0.00	5.51	0.99	6.50	6.60
6000569086222 Bishta Lopates 12	Bishta Lopates	18	0	1	COP	1.00	1.102	0.00	1.10	0.20	1.30	1.30
0000000003192 Kabell Proton e Fortë NYM 3x2.5 13	Kabell Proton e Fortë NYM 3x2.5	18	0	1	MET	1.00	0.847	0.00	0.85	0.15	1.00	1.00
0000000003212 Kabell Proton e butë HO5VV-F 4x1.5 14	Kabell Proton e butë HO5VV-F 4x1.5	18	0	1	MET	1.00	0.822	0.00	0.82	0.15	0.97	0.97
9000002842855 Klima Inv. MIDEA MSMADU-24HRFN 15	Klima Inv. MIDEA MSMADU-24HRFN	18	0	1	COPE	1.00	711.864	0.00	711.86	128.14	840.00	840.00
9000002842852 Klima Inv. MIDEA MSMABU-12HRDN 16	Klima Inv. MIDEA MSMABU-12HRDN	18	0	1	COPE	1.00	394.068	0.00	394.07	70.93	465.00	465.00

Edhe komisioni tjetër gjatë rivlerësimit ka dalë në hulumtim të tregut dhe ka konstatuar që për artikujt e lartekur O.E. ankues ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut. Më poshtë gjeni edhe çmimet të cilat komisioni i ri-vlerësimit i ka marr gjatë hulurimit të tregut:

Nr	Shifra	Emërtimi	Barkodi	Njësia	Sasia	Komenti	Çmimi	Zbr. (%)	Çm. me Zbr.	Vlera Pa Tësh	Tësh	Vlera Me Tësh
1	138341	Cilindri i derës CL2036 Nikel 80mm (30 -50) 3K DBP1	8605004213382	copë	1.00		7.50	7.00	6.98	5.91	18.00	6.98
2	138329	Cilindri i derës CL2036 Nikel 70mm (30 -40) 3K DBP1	8605004205011	copë	1.00		6.80	7.00	6.42	5.44	18.00	6.42
3	138317	Cilindri i derës CL2036 Mat Ms 54mm (27-27) 3K DBP1	8605004263029	copë	1.00		5.90	7.00	5.49	4.65	18.00	5.49
4	138316	Cilindri i derës CL2036 Mat Ms 42mm (21-21) 3K DBP1	8605004262992	copë	1.00		4.99	7.00	4.64	3.93	18.00	4.64
5	138299	Doreza e drithres KOPAONIK-P RAL9016Be 7x7 / 34 / 28x67x12 / 50 / 124mm DP1	8605004267989	copë	1.00		1.70	7.00	1.58	1.34	18.00	1.58
6	138295	Doreza rozete e derës DOLCE F1 f150 / 7/100/8 / 9mm Cil BPDQ	8605004254590	copë	1.00		5.90	7.00	5.49	4.65	18.00	5.49
7	138335	Doreza e derës rozetë për dyer alumini NELA Inox 30/65/10/120/8 / 9mm Cil DBP3	8605004200979	copë	1.00		13.50	7.00	12.66	10.64	18.00	12.66
8	138292	Doreza dere JELENA B-NI 90/42/254/10/108/8/9 .Klj DBP0	8605004250936	copë	1.00		11.90	7.00	11.07	9.38	18.00	11.07
9	30989	Lopatë me bisht 1300 t	3838717181557	copë	1.00		10.90	7.00	10.14	8.59	18.00	10.14
10	30987	Lopatë me bisht e kuqe	3838717397444	copë	1.00		9.90	7.00	9.21	7.80	18.00	9.21
11	20029	Fshesë UCM 82019000	3838717640052	copë	1.00		11.90	7.00	11.07	9.38	18.00	11.07
12	115153	Shati me bisht i zi	3838717379563	copë	1.00		10.90	7.00	10.14	8.59	18.00	10.14
13	140318	Kondicioner TCL 24BTU 24CHSD/ XAB1HB Smart -30	4820241600557	copë	1.00		999.00	7.00	929.91	788.06	18.00	929.91
14	43934	Rrafshuese me trapez 3000mm	VP6110	copë	1.00		11.60	7.00	10.79	9.14	18.00	10.79
15	128618	Ventilator metall Ø160WB-S	5901560515179	copë	1.00		34.90	7.00	32.46	27.51	18.00	32.46
16	128552	Ventilator Woks Ø 400	5901560503329	copë	1.00		134.90	7.00	125.46	106.32	18.00	125.46
17	124534	Bateri oborri 1/2 15902121	8696338033777	copë	1.00		5.49	7.00	5.11	4.33	18.00	5.11

Shifra	Emërtimi	Çmimi
11968	Grabuja Plastikes Kaltert 18x3.5cm	1.50
2770	Llopata me Bisht te Kuqe 6/1 Yildiz	4.00
9332	Cilinder 12183/CKZ 33 10 40 CP 3 Qelesë Siba	3.50
741	Cilinder 12183/C Qelesë 100/1 Siba	3.50
737	Cilinder 12168/CKZ 26 10 32 3 Qelesë 100/1 Siba	2.80
3659	Qeshme Vinus 1/2	2.50

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fonave publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për paranë, pasi që kemi pranuar oferta në të cilat në shumë pozicione janë ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut sikur kemi shpjeguar më lartë. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet

buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë. Ndërsa O.E. ankues duke vendosur çmimi të larta me pretendimin se çmimi i vendosur është ndikuar nga tregu dhe se çmimi i vendosur është paraparë për një janë përgatitur që të intervenojnë, edhe nëse është nevoja për intervenim në një dorezë të vetme për një herë, është në kundërshtim të dispozitave të nenit 1 të LPP-s pasi që nuk përshtatet me qëllimin e LPP-s për të siguruar vlerën për paranë. O.E. ankues është munduar që të arsyetoj çmimet e larta me lëvizje të çmimeve në treg, por që hulumtimi i tregut nga ana e të dy komisioneve të vlerësimit gjithmonë duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 4.1 pikat e Rregullores për prokurimin publik 001/2022 ka dëshmuar që çmimet në fjalë janë tepër të larta në krahasim me ato të tregut.

Më tej O.E. pretendon se janë shkelur dispozitat e nenit 4 pikat 4.1 dhe 4.4 të Rregullores për prokurimin publik, pretendim i cili është krejtësisht i pa bazë pasi që sikur kemi cekur më lartë këto dispozita janë aplikuar në tërësi duke siguruar transparencë, duke luajtur rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancitë. Është bërë krahasimi efektiv i kërkeseve për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuар avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet. Është siguruar që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut duke hulumtuar çmimet drejtpërdrejtë në treg.

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënavë të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartëkura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. O.E. ankues ka paraqitur një shumë enorme të shpenzimeve me qëllim të përfitimit të pa bazë dhe të pa drejtë. Andaj konsiderojmë se edhe ky pretendim është i pa bazë.

**Andaj,**

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 05.01.2023



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtares të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.